

24.01.2022
Ora 12:00

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PLL, PSD**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Fillojmë seancës e shqyrtimit të projektvendimit, që ka të bëjë me “Caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022”. I japim fjalën sekretarit për të relatuar mbi projektaktin, pastaj vazhdojmë me diskutimet e partive politike.

Z. Y. Merkaj: Kodi Zgjedhor, neni 29, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, përcakton se anëtarët e KZAZ-së, emërohen nga KQZ, sipas procedurës: dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës


**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet barazpeshimi politik, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në barazpeshimin politik shumicë-opozitë. Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare ndërsa në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare. Bazuar në përcaktimet e nenit 29, pika 4, të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendore në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare. Referuar nenit 183, pika 8 të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, e drejta e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë – pakicë të Kuvendit të Shqipërisë në çeljen e tij menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe korespondencës ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kuvendit të Shqipërisë, të administruara për zgjedhjet vendore të vitit 2019 kemi arësytuar si më poshtë vijon: Zgjedhjet e pjesshme vendore të vitit 2022, do të zhvillohen në 6 bashki të vendit vetëm për vakancat e krijuara për kryetarët e bashkive. Mandatet të cilat për arsye që ligji përcakton kanë mbetur vakant dhe janë ndërprerë, do të vijojnë të ushtrohen nga kryetarët e rinj që do të zgjidhen në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022 për periudhën e mbetur deri në vitin 2023. Neni 29 i Kodit Zgjedhor, përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve. Nga ana tjetër, vetë legjislatori ka përcaktuar një dispozitë kalimtare, nenin 183, pika 3 të Kodit Zgjedhor, e cila është e aplikueshme në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore pas hyrjen në fuqi të ndryshimeve të vitit 2020. Pikërisht këtë dispozitë zbatoi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, ku caktoi partitë të cilat gëzonin të drejtën për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

të propozuar anëtarët e KZAZ-ve. Në zgjedhjet e pjesshme të vitit 2022, zgjedhësit do të votojnë për kandidatët e bashkive të cilët do të ushtrojnë detyrën e cila është vazhdim i mandateve të dala nga zgjedhjet e vitit 2019 dhe që do të zgjasin deri në vitin 2023, kur do të zhvillohen zgjedhjet e para të pushtetit vendor pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të Kodit Zgjedhor. Nga sa më lart, dispozita tranzitore është e paaplikueshme për zgjedhjet e pjesshme të vitit 2022, pasi këto zgjedhje konsiderohen vazhdim i një mandati të ndërprerë dhe në përfundim të tyre, kryetarët e rinj nuk do të përfitojnë një mandat 4-vjeçar siç përcakton neni 109 i Kushtetutës. Në përcaktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet e pjesshme vendore të vitit 2022, do të zbatohet e njejta formulë që është aplikuar në vitin 2019, duke u bazuar në vendimin nr. 555, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të vitit 2017” dhe vendimit nr. 965, datë 10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore 2015”. Në referim të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 76/1 Prot., datë 23.01.2019, sipas këtyre vendimeve renditja e partive për efekt të zbatimit të procedurës për përbërjen e KZAZ-ve për zgjedhjet vendore 2019, është si më poshtë: Shumica parlamentare është Partia Socialiste e Shqipërisë. Pakica parlamentare është Partia Demokratike e Shqipërisë, Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet dhe Partia Socialdemokrate. Partia Socialiste e Shqipërisë, do të paraqesë tre kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve, dy kandidatura si parti e parë e shumicës parlamentare dhe kandidatura e tretë për të realizuar barazpeshimin politik shumicë - opozitë në përbërjen e KZAZ-ve. Partia e parë dhe e dytë e opozitës parlamentare të cilat do të propozojnë anëtarë të KZAZ-ve, janë Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste për Integrim. Sekretari i KZAZ-së do të propozohet nga Partia Socialiste

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

e Shqipërisë në KZAZ-të ku Partia Socialiste ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së dhe nga Partia Demokratike në KZAZ-të, ku Partia Demokratike ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së. Këtu kemi një ndryshim nga projekti i paraqitur dje, sepse ishte bërë një gabim dhe e ndryshuam këtu. Projektvendimi është gati për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesit e partive politike janë dakord në parim! Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kam vetëm një pyetje. Në vitin 2019, besoj se është marrë një vendim analog si ky vendim. Si ka qenë ndarja e anëtarëve të KZAZ-ve. Pra, sa anëtarë do të kishte secila prej partive dhe cilat kanë qenë partitë? Në qoftë se e ka këtë informacion administrata. Duke qenë se u tha që do të zbatohet e njejta formulë, ose do të ndiqet e njejta praktikë që u ndoq në zgjedhjet e vitit 2019.

Z. Y. Merkaç: Po, kjo është e njejta formulë që është ndjekur në 2019. Shumicë parlamentare është konsideruar Partia Socialiste, pakicë parlamentare Partia Demokratike, LSI, PDIU dhe PSD.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Pra dhe në zgjedhjet vendore të vitit 2019 ka pasur tre anëtarë të KZAZ-ve Partia Socialiste, dy anëtarë Partia Demokratike dhe një anëtar Lëvizja Socialiste për Integrim dhe anëtari i shtatë është hedhur me short? Kështu ka qenë? Dakord! Një pyetje tjetër në qoftë se mundem. Ndoshta vetëm për t'u sqaruar. Lidhur me shortin do procedohet sot?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

Z. I. Celibashi: Po, sot. Thjesht për të respektuar procedurën jeni dakord me projektaktin në parim?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, parimisht jemi dakord!

Z. I. Celibashi: Besoj dhe përfaqësuesit e partive të tjera?! Dakord! Vazhdojmë zoti Marash!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për sa i përket dhe përmbajtjes nen për nen, nuk kemi gjë përveç asaj që i kemi komunikuar dje administratës që ishte një lapsus dhe është korigjuar siç e relatoi dhe Sekretari i Përgjithshëm. Nuk kemi ndonjë kundërshti tjetër në lidhje me përmbajtjen e aktit.

Z. I. Celibashi: Në rregull, faleminderit! Përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Kryetar, pasi dëgjuam relacionin që është bërë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, jemi parimisht dakord përpara faktit që ndodhemi përpara zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për këto 6 njësi vendore të cilat do të zhvillohen në datën 6.03.2022, sipas dekretit të Presidentit të Republikës, ne kemi marrë dijeni ditën e djeshme për aktin. Jemi njohur me të. Jemi parimisht dakord dhe me frymën e aktit dhe logjikën e tij. Duam të vemë në dijeninë tuaj si Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka disa lapsuse mendoj unë, të karakterit të formës në vetvehte. I

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022**

referohem faqes së tretë të tij duke qenë se akti nuk është i ndarë në pika që t'i japë shpjegimet lidhur me pikën..

Z. I. Celibashi: Tek relacion!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ekzakt! Është faqja e tretë, atje ku saktësohet se.., citoj “bazuar në vendimin nr. 555, dt. 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të vitit 2017”, në prezencë të një vendimmarrje të mëvonëshme të bërë nga Komisioni Rregullator, i cili mban nr. 21, dt. 13.07.2021, do të donim që kjo të ndryshojë me vendimmarrjen e Komisionit Rregullator, lidhur me caktimin e kësaj vendimmarrjeje për zgjedhjet e Kuvendit 2021. Po ashtu përpara tavolinës jo më parë se 10 minuta na është vënë nga ju në dispozicion një shkresë, me lëndë “Kthim përgjigje”, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë me firmën e Kryetares së Kuvendit. Në të disponohet qartësisht se partitë politike parlamentare dhe numri i deputetëve për çdo parti politike janë konfiguruar si më poshtë. Duke dhënë konfigurimin e parlamentit aktual. Do të doja që kjo pjesë, duke marrë parasysh këtë shkresë zyrtare nga Parlamenti i Shqipërisë të reflektonte në pjesën ku ju i referoheni shkresës 76/1, prot. dt. 23.01.2019. Normalisht do të duhet të ndryshojë dhe pjesa arësytuese e aktit, duke qenë se i referoheni kësaj shkrese dhe këtij konfigurimi, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po në lidhje me se si do të konfigurohen KZAZ-të, në thelb nuk keni pretendime?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo nuk kemi, ekzakt!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë Socialdemokrate?

Z. Rr. Preçi, përfaqësues i PSD-së: Nuk kemi asnjë pretendim!

Z. I. Celibashi: Në lidhje me këtë, përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për sa kohë do të përdoret e njejtja formulë që është përdorur në zgjedhjet vendore të vitit 2019, shkresa që është administruar sot nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, praktikisht nuk ndryshon asgjë. Mund ta vendosim si informacion referues, por nuk mendoj se do të sillte ndonjë efekt. E vlerësoj të panevojshme ngarkesën më shumë se sa është të vendimit që do të marrë sot Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pra, duke qenë se të gjitha palët këtu po dakordësohemi që formula e përzgjedhur është ajo që është përdorur... ose mënyra, modaliteti është ai i përdorur dhe në zgjedhjet e vitit 2019, mendojmë që të vazhdojmë më të njejtën formë siç është prezantuar projektvendimi, me ato korrigjime të vogla, të cilat besoj janë rakorduar tashmë nga administrata.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Mendoj që mënyra e konfigurimit të subjekteve politike dhe e Kuvendit të Shqipërisë në tërësi, ardhur nëpërmjet një informacioni të dhënë nëpërmjet një shkrese që mban datën e sotme, ka shumë rëndësi dhe për vijimësinë në vetvehte të aktit të themi, apo dhe akteve të tjera që do të marrë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, apo komisionet e tjera që janë në përbërje të KQZ-së.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

Z. I. Celibashi: E kuptoj, ajo çfarë dua të them është kjo që anëtarësia e KZAZ-së ka dy momente nga pikëpamja rregullatore. Ka rregullimin normal, të përcaktuar nga neni 29, ka dhe rregullimin tranzitor të përcaktuar nga neni 183 të Kodit Zgjedhor. Neni 183 i Kodit Zgjedhor, i referohet zgjedhjeve të para vendore pas hyrjes në fuqi të këtij kodi. Pyetja është “janë apo s’janë këto zgjedhjet e para vendore?”. Besoj se të gjithë dakordësohemi se nuk janë këto zgjedhjet e para vendore është vazhdimësi. Kështu që në thelb baza ligjore mbetet e pandryshueshme. Është neni 29, pika 1 dhe 4 të Kodit Zgjedhor. Këto janë zgjedhje të pjesshme si të thuash janë zgjedhje të vitit 2019. Nuk jemi tek zgjedhjet e përgjithshme vendore të rregullta, të cilat mbahen në 2023.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Pra, nuk kemi mandatin 4-vjeçar, por vazhdimësinë e mandatit për shkak të vakancave të krijuara.

Z. I. Celibashi: Po dhe palët e pranojnë këtë!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Patjetër!

Z. I. Celibashi: Faleminderit për kontributet, atëherë e miratojmë projektaktin sipas propozimit të paraqitur, sipas të cilit përbërja e KZAZ-ve do të jetë:
Tre anëtarë do të propozohen nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
Dy anëtarë do të propozohen nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
Një anëtar do të propozohet nga Lëvizja Socialiste për Integrim;
Anëtari i shtatë i KZAZ-ve do të hidhet me short ndërmjet Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë Demokratike të Shqipërisë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

Në se jeni dakord, ne procedurën e shortit mund ta zhvillojmë pas një ore, ose pas dreke si e mendoni?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jemi dakord i nderuar, që të procedojmë sa më shpejt se siç e dini edhe ju besoj, të shtunën Komisioni Rregullator, ka miratuar afatin që është dita e nesërme. Është e nevojshme që partitë politike sidomos partitë politike që kanë të drejtën për të propozuar anëtarët dhe sekretarët të procedojnë sa më shpejt. Kështuqë është e përshtatshme të zhvillohet në një kohë sa më të shpejtë.


Z. I. Celibashi: Atëherë, në orën 13:15, po rimblidhemi përsëri për të zhvilluar procedurën e shortit. E kishim njoftuar për mbasdite, por jam dakord me konsideratën tuaj dhe në orën 13:15, zhvillojmë procedurën.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Asnjë kundërshtim, ne jemi thjesht vëzhgues në këtë short, se e ka ndarë ligjvënësi se kujt i takon.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Vendimi nr. 5

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



24.01.2022
Ora 13:43

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partive që do të propozojnë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (M.Logu)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Sikurse vendosëm në seancën e mëngjesit zhvillojmë procedurën e shortit për caktimin e partive që do të propozojnë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, që ndahet midis Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Kemi ndonjë diskutim paraprakisht përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo nuk kemi!

Z. I. Celibashi: Mirë vazhdojmë me procedurën e shortit, i japim fjalën sekretarit për të filluar me procedurën dhe pastaj vazhdojmë.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

Z. Y. Merkaç: Komisioni Rregullator, në zbatim të kriterëve të përcaktuara me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, në nenin 4 të tij përcakton procedurat për organizimin në seancë publike të hedhjes së shortit nëpërmjet partisë së parë të shumicës parlamentare dhe partisë së parë të opozitës parlamentare. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin e shortit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 5, datë 24.01.2022 ka përcaktuar se anëtari i shtatë do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, parti e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike, parti e parë e opozitës parlamentare. Shorti që do të hidhet për caktimin e partisë politike që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, do të përfshijë trembëdhjetë KZAZ, konkretisht:

- a) Bashkia Shkodër përfshin katër Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 2,3,4,5), numër çift;
- b) Bashkia Dibër përfshin një Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 19), numër tek;
- c) Bashkia Durrës përfshin katër Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 21, 22, 23, 24) numër çift;
- d) Bashkia Vorë përfshin një Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 26), numër tek;
- e) Bashkia Rrogozhinë përfshin një Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 43) numër tek;
- f) Bashkia Lushnje përfshin dy Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 54, 55), numër çift.

Kriteri i përcaktuar në nënparagrafin e dispozitës neni 29, pika 1 të Kodit Zgjedhor, “shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor”, mund të zbatohet në masën 100% në bashkitë Shkodër, Durrës dhe Lushnje ku numri i KZAZ-ve është çift. Ndërsa për Bashkitë Dibër, Vorë dhe Rrogozhinë nuk mund zbatohet në masën 100%, pasi këto

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

bashki kanë nga një ZAZ secila. Për këtë do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit midis këtyre tre KZAZ-ve, se cilës parti i takon anëtari i shtatë i KZAZ-ve. Për këtë kemi dy enë transparente ku në njërin janë vendosur emrat e partive në shirita letre, të cilat mbyllën në dy gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë. Vazhdojmë me procedurën e shortit. Në enën tjetër transparente do të vendosen dy shirita letre ku në shiritin e parë shkruhet “KZAZ-të e numërtuar me numër tek” dhe në shiritin tjetër “KZAZ-të e numërtuara me numër çift”. Një nëpunës i administratës së KQZ, konkretisht Klodiana, tërheq një nga goglat që ndodhen në enën e parë ku janë shiritat me emrin e partive politike. Nga gogla doli shiriti me emrin e Partisë Demokratike. Sipas shortit përfaqësuesi i Partisë Demokratike, tërheq i pari njërin nga dy goglat e enës së dytë ku janë shiritat e letrës së shkruar KZAZ-të tek dhe çift. Ftojme përfaqësuesin e Partisë Demokratike të tërheqë në enen transparente për KZAZ-të tek, ose çift.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Autorizoj përfaqësuesen e KQZ-së të tërheqë.

Z. Y. Merkaç: Nga rezultati i shortit del që Partia Demokratike ka të drejtë të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve me numër çift dhe konkretisht: KZAZ-ja nr. 26, Bashkia Vorë. Dy KZAZ-të e tjera Bashkia Dibër KZAZ-ja nr.19, Bashkia Rrogozhinë KZAZ-ja nr. 43 anëtari i shtatë do të propozohet nga Partia Socialiste. Ky ishte rezultati i shortit, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, nuk besoj se kemi diskutime! E mbyllim këtë pikë të rendit të ditës.

Vendimi nr. 7

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**24.01.2022
Ora 13:49**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, KQV-së, Kryetarit të KQV-së dhe vulës rezervë për KQV-në për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Z. Y.Merkaj, Znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (M.Logu)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulave. I japim fjalën Sekretarit të KQZ-së.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 99, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror I Zgjedhjeve dërgon në KZAZ-të materialet zgjedhore që do të përdoren në administrimin e procesit zgjedhor në dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë, përfshihen vula e KZAZ-së, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, vula rezervë për KQV-të. Kodi Zgjedhor, në nenin 103, në pikën 2, përcakton tekstin që duhet të përmbajë:

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.01.2022*

- Kodi Zgjedhor, në nenin 103, në pikën 2, përcakton tekstin që duhet të përmbajë:
- vula e KQV-së “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit;
 - vula e kryetarit të KQV-së “KRYETARI” dhe një numër serial pesëshifror;
 - vula rezervë: teksti është unik për secilën vulë, përcaktuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 11, datë 28.12.2020.

Formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së, vulës së KQV-së, vulës së Kryetarit të KQV-së dhe vulat rezervë për Komisionet e Qendrave të Votimit, referojnë përcaktimet e VKM nr. 390, datë 6.08.1993, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit, dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, të ndryshuar. Ato prodhohen në sektorin e prodhimit të vulave zyrtare, pranë Ministrisë së Brendshme, me kosto një mijë e tetë qind lekë, për vulë. Për sa më lart, brenda kompetencave të Komisionerit, kemi paraqitur projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Gjithashtu bashkëlidhur keni formatin dhe specifikimet e vulave të KZAZ-së, të KQV-së, kryetarit të KQV-së si dhe vulat rezervë, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit i nderuar! Jemi njohur me projektvendimin e përgatitur nga administrata e KQZ-së. Nuk kemi asnjë lloj rezerve, apo komenti ndaj këtij vendimi dhe jemi parimisht dakord!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, meqenëse nuk kemi kërkesa e propozime ndaj këtij projektakti, e miratojmë atë sipas propozimit të ardhur! Pikë tjetër? Nuk kemi! Faleminderit, seanca mbyllet!

Vendimi nr. 8

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

